

V E N D I M
Nr. 243, datë 20.4.2001

PËR DETYRIMIN E LËSHIMIT TË KUPONAVE TATIMORË, ME ANË TË
ARKAVE REGJISTRUESE

(Ndryshuar me VKM nr.368, datë 27.5.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, të ndryshuar me ligjet nr.7900, datë 8.12.1995 dhe nr.8147, datë 11.9.1996, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tatimpaguesit, të cilët shesin mallra dhe prodhime, apo kryejnë furnizime a shërbime në lokale apo njësi fikse të hapura për publikun, detyrohen të vendosin arka regjistruese, për lëshimin e kuponave tatimorë, për sa më sipër.

2. Sigurimi i arkave regjistruese bëhet nga vetë subjektet, që janë të detyruara të pajisen me to. Ministri i Financave, me udhëzim, përcakton karakteristikat dhe treguesit e domosdoshëm, që duhet të ketë arka regjistruese. Shërbimi i vendosjes së arkave regjistruese në njësi, sigurohet nga vetë tatimpaguesit.

3. Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin arkën regjistruese, në mënyrë të vazhdueshme. Në rast defekti, riparimi i arkave regjistruese sigurohet nga vetë tatimpaguesit. Gjatë kohës që arka regjistruese është në riparim apo nuk është në gjendje pune, tatimpaguesit evidentojnë qarkullimin e realizuar nëpërmjet dëftesës tatimore.

4. Tatimpaguesit, që kanë vendosur në njësi arka regjistruese, janë të detyruar të lëshojnë, për çdo rast, kuponin tatimor për shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve ndaj klientëve.

5. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari ambulante, profesione të lira dhe kanë njësi artizanale, nuk janë të detyruar të vendosin arkë regjistruese dhe të evidentojnë të ardhurat nëpërmjet saj. Ministri i Financave, me udhëzim, detajon të gjitha llojet e veprimtarive të përmendura më sipër.

6. Afati përfundimtar i pajisjes së njësive të tatimpaguesve me arka regjistruese është data 1 tetor 2001.

7. Ndaj tatimpaguesve, të cilët janë të detyruar të vendosin dhe të përdorin arkën regjistruese dhe nuk e kanë vendosur atë, *deri më 1 tetor 2001*, pas kësaj date merren masa administrative, sipas ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, ndryshuar me ligjet nr.7900, datë 8.12.1995 dhe nr.8147, datë 11.9.1996.

8. Ministri i Financave nxjerr udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.43, datë 14.2.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për detyrimin e personave fizikë dhe juridikë, për t’u pajisur me arka regjistruese” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta